REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA DEVOLL
DREJTORIA E SHËRBIMEVE SOCIALE, SHËNDETËSORE DHE STREHIMIT
SEKTORI I KUJDESIT SOCIAL DHE PAK

Nr. Prot. **Bilisht më, . .2025**

PROJEKT-VENDIM
NR 3 / DATË 21 / 01 /2025

"PËR MIRATIMIN E SISTEMIT TË PIKËZIMIT PËR PROGRAMIN "SUBVENCIONIM QIRAJE PER VITIN 2025"

Mbështetur në Ligjin nr. 139/2015 datë 17.12.2015, "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar, nenin 8 pika 2, nenin 9 pika 1 dhe 1.1, shkronja "b", nenin 24, 54, Ligjit 68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore", në Ligjin nr. 22/2018 "Për Strehimin Social"I ndryshuar , neni 15, pika 34 dhe VKM-në nr. 384, datë 12.06.2019, "Për përcaktimin e dokumentacionit për të përfituar strehim sipas çdo programi social të strehimit dhe të afateve e të procedurave të miratimit nga organet e qeverisjes vendore", VKM nr. 362, datë 29.05.2019 "Për kriteret e dhënies së subvencionit të qirasë për kategoritë që gëzojnë përparësi në subvencionimin e qirasë në tregun e lirë, nëpërmjet buxhetit të shtetit dhe mënyrën e llogaritjes së tij":

PROPOZOJ:

I .Miratimin e sistemit të pikëzimit, për programin "Subvencioni i qirasë", i cili njëkohesisht do të aplikohet edhe on line në sistemin softuerik "FortiClient VPN" për familjet e pastreha si më poshtë :

NR	KRITERET	PIKET
A	**KUSHTET E STREHIMIT**	**25 PIKE**
1	I pastrehë si rezultat i fatkeqësive natyrore	4
2	I pastrehë nga proçeset gjyqësore	2
3	Banesë që prishet/përjashtohet nga legalizimi	2
4	Banesë në rrezik shembje	2
5	Nuk disponon banesë në pronësi	15
B	**KUSHTET FAMILJARE**	**25 PIKE**
6	Çift me moshë jo më të madhe se 60 vjeç.	7
7	Familje me më shumë se 4 fëmijë	4
8	I/E moshuar që kanë mbushur moshën e pensionit dhe nuk janë përzgjedhur	4

Adresa: Lagja Nr. 1, Rr. 24 Tetori Nr. 9; Tel+35581122288; E-mail: bashkiadevoll@gmail.com; ëeb: http://bashkiadevoll.gov.al/

	për tu strehuar në një institucion publik të përkujdesjes	
9	Famije njëprindërore që kanë në ngarkim fëmijët	10
10	Asnjë nga kushtet	0
C	**KUSHTET SOCIALE**	**25 PIKE**
11	Anëtar i famijes që trajtohet me ndihmë ekonomike	**2**
12	Anëtar i komunitetit egjiptian	2
13	Anëtar i komunitetit rom	2
14	Azilkërkues	1
15	Emigrantët e rikthyer / punëtorët emigrantë	1
16	Familjet e punonjësit te Policisë së Shtetit të rënë në detyrë	1
17	I mitur në konflikt me ligjin	1
18	Ka mbetur i pastrehë për shkak të lirimit të banesës së ish-pronarëve	1
19	Ka në përbërje familjare një individ me aftësi të kufizuar	4
20	Ka statusin e jetimit dhe moshë deri në 30 vjeç	1
21	Komuniteti LGBTI	1
22	Punonjës i RENEA-s	1
23	Punonjës i Repartit të Ndërhyrjes së Shpejtë (FNSH)	1
24	Punonjës i shpëtimit dhe i mbrojtjes nga zjarri	1
25	Vajza-Nëna	1
26	Viktimë e dhunës në familje	3
27	Viktimë e trafikimit	1
28	Asnjë nga kushtet	0
Ç	**KUSHTET EKONOMIKE**	**25 PIKE**
29	Familje me të ardhura mesatare	**1**
30	Familje me të ardhura shumë të ulëta	**5**
31	Familje me të ardhura të ulëta	4
32	Familje pa të ardhura	15

2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet: Drejtoria e Shërbimit Social dhe Komisioni i Strehimit.

3.Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6, të nenit 55 të ligjit 139/2015 për "Vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar.

Konceptoi: Specialiste për administrimin e nevojave për strehim
Linda Laçi
Konfirmoi: Përgjegjëse i sektorit të Kujdesit Social
Marilda Bejleri
Miratoi: Drejtor i Shërbimeve Sociale, Shëndetësore dhe Strehimit
Zerina Sinani
Konfirmoi bazen ligjore:
Përgjegjëse e Sektorit Juridik
Eriksela Avdo

KRYETARI I BASHKISË
Eduard Duro

Adresa: Lagja Nr. 1, Rr. 24 Tetori Nr. 9; Tel+355811322388; E-mail: bashkiadevoll@gmail.com; ëeb: http://bashkiadevoll.gov.al/

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA DEVOLL
DREJTORIA E SHËRBIMEVE SOCIALE, SHËNDETËSORE DHE STREHIMIT
SEKTORI I KUJDESIT SOCIAL DHE PAK

Nr.208 Prot, **Bilisht më, 21.01. 2025**

RELACION
PËR SISTEMIN E PIKËZIMIT

Në mbështetje të Ligjit Nr.139/2015 datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore "neni 8 pika 2 i cili percakton se, organet e njësive të qeverisjes vendore ushtrojnë kopetencat e tyre nëpërmjet vendimeve, urdhëresave dhe urdhërave, sic jane e drejta dhe përgjegjësia per te marre masa që ato i gjykojnë të nevojshme për kryerjen e funksioneve dhe ushtrimin e kompetencave ne nenin 30 pika 7 percaktohet e drejta e bashkëpunimit sipas se cilës:
"Pwr kryerjen e shërbimeve specifike në emër dhe në dobi të komuniteteve përkatëse , dy ose më shumë njësi të vetëqeverisjes vendore mund te ushtrojnë së bashku çdo funksion që u është dhënë atyre me ligj , nëpërmjet zbatimit të marveshjeve ose kontratave të përbashkëta, delegimit të kompetencave dhe përgjegjësive të vecanta njëra – tjetrës ose kontraktimit me një palë të tretë dhe në zbatim të Ligjit Nr.22/2018 "Për Strehimi Social", VKM nr.1093 datë 28.12.2015, "Për miratimin e procedurave, kritereve dhe përparësive për dhënien e bonusit të strehimit" i ndryshuar, i cili përcakton qartë procedurat dhe kriteret për dhënien e bonusit të strehimit për familjet e pastreha. Në vendimin për miratimin e buxhetit miraton gjithashtu dhe numrin maksimal të punonjësve të bashkisë si dhe të njësive të instituconeve buxhetore në vartësi të bashkisë. ", si dhe VKM nr. 362, datë 29.05. 2019 "Për kriteret e dhënies së subvencionit të qirasë për kategoritë që gëzojnë përparësi në subvencionimin e qirasë në tregun e lirë, nëpërmjet buxhetit të shtetit dhe mënyrën e llogaritjes së tij".
Sipas projektit të Minsitrisë së Finacave dhe Ekonomisë për bashkitë e vendit do të funsionojë sistemi kompjuterik on-line i hedhjes së të dhënave të aplikantëve për programet e strehimit, duke përdorur një sistem softuerik "FortiClient VPN" i cili ofron një sërë veçorish duke përdorur kriptim IP sec dhe SSL optimizim WAN, pajtueshmëri në pikën përfundimtare për vërtetim me dy faktorë.
Entet menaxhuese në qytet, që kanë treg banesash me qira në bazë të vendimit të këshillit bashkiak i japin familjes që përfiton nga banesat sociale me qira, të cilat plotësojnë kushtet të përcaktuara në nenin nr.36 "Subvencionimi i qirasë për banesat në pronësi të pronarit social" kur:
a) Nuk zotërojnë fonde për investime të reja ose blerje banesash në treg.
b) ndërtimi ose blerja e banesave nga tregu është më i kushtueshëm sesa subvencionimi i qirave.
Në zbatim të pikës 2 të nenit 36 bëjnë përjashtim nga kushtet e parashikuara në pikën 1, të këtij neni, rastet kur njësitë e vetëqeverisjes vendore konstatojnë se:

a)familja që kërkon të strehohet në banesa sociale me qira banon në një banesë me qira , e cila ndodhet pranë vendit të punës, shkollës së fëmijëve, qëndrave shëndetësore ose pranë shërbimeve të tjera:

b) banesa sociale me qira është siguruar me financim nga persona juridikë privatë dhe qiraja është sipas pikës 5, të nenit 30 të këtij ligji.

Përzgjedhje e subjekteve dhe familjeve përfituese bëhet nëpërmjet një sistemi pikëzimi, i cili miratohet dhe publikohet për çdo program nga njësia e vetëqeverisjes vendore, bazuar në parimet e parashikuara në këtë ligj, si dhe kriteret e bëra publike para fillimit të proçesit.
Në përzgjedhjen e subjekteve përfituese me anë të sistemit të pikëzimit përfshihen individë/familje, të cilët përmbushin nivelin e të ardhurave të parashikuara sipas çdo programi.Njësitë e vetëqeverisjes vendore hartojnë, miratojnë dhe publikojnë sistemin e pikëzimit për çdo vit, të specifikuar për çdo njësi të vetëqeverisjes vendore dhe për çdo program që zbatohet, bazuar në kriteret e përcaktuara në këtë ligj.

VKM Nr. 362, datë 29.5.2019 "Për kriteret e dhënies së subvencionit të qirasë për kategoritë që gëzojnë përparësi në subvencionimin e qirasë në tregun e lirë, nëpërmjet buxhetit të shtetit, dhe mënyrën e llogaritjes së tij"jane percaktuar kategorite si me poshte:
a) individët me statusin e jetimit;
b) personat me aftësi të kufizuar;
c) të moshuarit;
ç) invalidët e punës;
d) familjet e policëve të rënë në detyrë;
dh) emigrantët e rikthyer;
e) punëtori emigrant;
ë) azilkërkuesit;
f) familjet e komunitetit rom;
g) familjet e komunitetit egjiptian;
gj) viktimat e dhunës në familje;
h) viktimat e trafikimit/viktimat e mundshme të trafikimit;
i) prindërit e vetëm, që kanë në ngarkim fëmijë;
j) individët, që i përkasin komunitetit LGBTI;
k) të miturit, 14–18 vjeç, dhe të rinjtë, 18–21 vjeç, në konflikt me ligjin;
l) vajzat nëna, pas daljes nga programi i banesave sociale të specializuara;
ll) familjet me statusin e qiramarrësit në banesa ish-pronë private, sipas aktit normativ me fuqinë e Ligjit nr. 3, datë 01.03.2012.
Radha e përparësisë së këtyre kategorive përcaktohet në përputhje me sistemin e pikëzimit, që miratohet me vendim të këshillit të njësisë së vetëqeverisjes vendore. Pesha e pikëve që njësia e vetëqeverisjes vendore i ngarkon kategorive të referuara në pikën 2, të këtij vendimi, varet nga përqindja që zë secila kategori ndaj totalit, bazuar në numrin e përgjithshëm të aplikimeve të këtyre kategorive.
Ministria përgjegjëse për strehimin përcakton kategoritë që gëzojnë përparësi për përfitimin e subvencionimit të qirasë, kur financon ose bashkëfinancon nga buxheti i shtetit. Përparësitë përcaktohen çdo vit, bazuar në prioritetet e programeve qeveritare.
Që një familje/individ të përfitojë subvencionimin e qirasë duhet të plotësojë kriteret e përcaktuara në njërin prej rasteve të shkronjës "a", të nenit 16, të ligjit nr. 22/2018, "Për strehimin social", dhe të mos ketë të ardhura më të larta se ato të përcaktuara në nenin 20, të tij.
Njësia e vetëqeverisjes vendore përcakton vlerën konkrete të subvencionimit të qirasë për

banesat në pronësi të pronarit social në tregun e lirë, bazuar në:
a) vlerën mesatare të qirasë në tregun e lirë, e cila vlerësohet sipas zonave të ndryshme urbane
e rurale të një njësie të vetëqeverisjes vendore;
b) të ardhurat familjare, sipas kategorizimit të pikës 44, të nenit 2, të ligjit nr. 22/2018;
c) aftësinë e familjes për të përballuar pagesat mujore të qirasë, sipas përcaktimeve të nenit 3, të ligjit nr. 22/2018.
Masa e subvencionimit të qirasë për çdo individ/familje llogaritet si diferenca ndërmjet qirasë reale, që paguan familja, dhe aftësisë së individit/familjes për të përballuar pagimin e qirasë, e cila llogaritet për 12 muajt e fundit. Qiraja reale nuk mund të jetë më e lartë se qiraja mesatare, sipas shkronjës "a", të pikës 4, të këtij vendimi.
Masa e subvencionimit të qirasë është:
a) e plotë, për të gjithë vlerën e qirasë të përcaktuar për familjet pa të ardhura, sipas përcaktimit të shkronjës "ç", të pikës 45, të nenit 2, të ligjit nr. 22/2018;
b) e pjesshme dhe në raport të zhdrejtë me të ardhurat mesatare të individit/familjes, në përputhje me kategorizimin e parashikuar nga shkronjat "b" e "c", të pikës 45, të nenit 2, të ligjit nr. 22/2018, sipas formulës në shtojcën "A", që i bashkëlidhet këtij vendimi. Kur subvencioni i qirasë është i pjesshëm, shihet mundësia e uljes së tij pas tre muajve, në varësi të të ardhurave që mund të vijnë nga punësimi apo burime të tjera të ligjshme për individët/familjet që përfitojnë prej tyre;
c) e barabartë me zero, kur një familje me të ardhura mujore mesatare shpenzon më pak se 25% të të ardhurave mujore për pagesën e qirasë.
Ministria përgjegjëse për strehimin, mbështetur në kërkesat e njësive të vetëqeverisjes vendore, garanton fondet buxhetore vjetore për subvencionimin e qirasë për banesat e pronarëve socialë në tregun e lirë. Jo më pak se 80 përqind e familjeve që përzgjidhen të trajtohen në banesa sociale me qira duhet të kenë të ardhura nga 0 deri 100% të të ardhurave mesatare familjare të njësisë së vetëqeverisjes vendore përkatëse. Jo më pak se 5 % e përfituesve duhet të plotësohen nga familje të minoritetit Rom dhe egjiptian. Jo më shumë se 20 përqind e familjeve mund të përzgjidhet brenda intervalit 100-120 % për qind të nivelit të të ardhurave mesatare.

Përgjegjës i Sektorit të Kujdesit Social
Marilda Bejleri